



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **69**

Prishtinë, më 8.5.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Salih Morina, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH me Arben Çitakun, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca, NDI-Shefki Kastrati, Ambasada Amerikane, dy ekspertët E. Surdulli dhe F. Selmani, zyrtar nga Habitati) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 7.5.2012,
3. Projektligji për Ndërtimin,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7.5.2012.

3. Projektligji për Ndërtimin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoj të pranishmit duke filluar menjëherë me shqyrtimin e Projektligjit. Komisioni shqyrtoi vërejtjet konkrete deri tek Neni 6 duke konstatuar si vijon :

- Te Neni 1 kontestuese është fjala “certifikatë”, për të cilin shprehje ekspertit prezent nga Amerika tha se është term i standardeve ndërkombëtare dhe nuk kundërshtoi mbetjen në ligj, ndërsa ekspertit i komisionit (z. Selmani) tha se është term anglo-sakson. **Salih Morina** sugjeroi të konsultohen ekspertët mes vedi.
- Te Neni 3 përfaqësuesi i Arkitektëve z. **Valdet Osmani** pyeti pse në Ligj duhet të figuroi ISO dhe sugjeroi të mbetet vetëm “Kosova dhe BE”. **Kryetari dhe Nijazi Idrizi** sugjeruan përfshirjen e standardeve të duhura për një ligj efikas. **Liburn Aliu** insistoi të harmonizohen qëndrimet me propozimet e ekspertit Ylber Vokshi.
- Te Neni 4 u kundërshtua parimi “heshitja është pranim” nga disa të pranishëm dhe u kërkua të përfshihet edhe Kodi i Ndërtimit.

Kryetari i Komisionit caktoi takimin e radhës duke kërkuar nga ekspertët e komisionit të përmbledhin vërejtjet dhe të sugjerojnë vërejtjet konkrete për komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 17,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani